



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:017468

Datë: 09.02.2024

Numri i dokumentit: 05306489

KPPP.nr. 98/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Construmax SH.P.K., me numër unik identifikues 811273739, me seli Suharekë, rruga “Mentor Krasniqi” p.n, kundër debitorit Komuna e Prishtinës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 717/23 të datës 18.12.2023, të Përmbartuesit Privat Rrezarta Metaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 09.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit Komuna e Prishtinës, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 717/23 të datës 18.12.2023, të Përmbartuesit Privat Rrezarta Metaj.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr. 717/23 të datës 18.12.2023, të Përmbartuesit Privat Rrezarta Metaj.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr. 717/23 të datës 18.12.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm – Fatura FSM-23-000030 e datës 27.09.2023, me të cilin e ka detyruar debitorin që t’ia paguaj kreditorit shumën e borxhit kryesor në vlerë prej 57,583.37€ (pesëdhjetë shtatë mijë dhe pesëqind e tetëdhjetë e tre euro dhe tridhjetë e shtatë cent) brenda 7 ditësh nga dita e dorëzimit të urdhrin, duke llogaritur edhe kamatën 8% në vit nga dita e pranimit të urdhrin e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor duke theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e kreditorit pasi që nuk i ka mbështetur

në prova ndërsa fatura e dërguar është e pa pranueshme sepse nuk i plotëson kriteret ligjore për të qenë dokument i besueshëm, ngase nuk është e nënshkruar nga debitori dhe për debitorin është i panjohur burimi i faturës. Gjykatës i ka propozuar që të aprovoj si të bazuar prapësimin e debitorit dhe të shfuqizoj Urdhrin Përmbartimor P.nr. 717/23 të datës 18.12.2023.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të cekura në prapësim, duke theksuar se pretendimet e debitorit janë në kundërshtim me gjendjen faktike pasi që vula e protokollit të debitorit e datës 27.09.2023 në faturë dhe pagesa në vlerë prej 64,997.48€ me datë 15.11.2023 dëshmojnë se debitori ka pranuar faturën. Tutje ka shtuar se fatura rrjedh sipas Kontratës Publike 616-22-12444-5-2-1/C1072 të lidhur nga debitori si Autoritet Kontraktues dhe kreditori me numër të prokurimit 616-22-184-521 për aktivitetin e prokurimit Rikonstruktivimi dhe mirëmbajtja e shkollës Gjergj Fishta Lot 2, e cila është e përshkruar në faturë. Gjykatës i ka propozuar që pas shqyrtimit të kësaj çështje juridike ta refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit

1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm – përkatësisht – Fatura FSM-23-000030 e datës 27.09.2023 e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këtë faturë, janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, është i përshkruar objekti i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe e njëjta është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, e cila vërtetohet nga vula e protokollimit të debitorit. Gjykata po ashtu vlerësoi se debitori ka përmbushur një pjesë të detyrimit që rrjedhë nga fatura e lartcekur prandaj vendosi si pikën I dhe II të dispozitivit.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura e lartcekur i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është dorëzuar në origjinal, mban vulën e pranimit të debitorit.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 71 dhe 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.98/24, datë 09.02.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.